

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Mr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Isa Shala e Gani Avdiu anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit F.T. nga Prishtina të cilin e përfaqëson M.D., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, të cilën e përfaqëson i autorizuari Z.Sh., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga e paditura, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 399/11 të dt. 10.07.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.05.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishtë të ankesës, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 399/11 i dt. 10.07.2012, vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar dhe gjykohet: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë 10.07.2012 e deri te pagesa e plotë, ndërsa sa i përket pjesës tjetër, ankesa e të paditurës REFUZOHET si e pathemeltë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 399/11 i dt. 10.07.2012, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Historiku procedural:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit është miratuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit F.T. nga Prishtina dhe është detyruar e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të pësuar nga lëndimi në punë me datën 07.09.2007 t;ia paguaj dhe atë: për dhembje fizike, shumën prej 2.000 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësorë, shumën prej 1.500 €, për frikën e pësuar, shumën prej 1.000 €, për ushqim të përforcuar, shumën prej 200 €. Të gjitha këto me kamatë prej 3.5 % që nga data 26.12.2008 e deri në pagesën definitive. Në pikën II., të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuara dhe atë: për dhembje fizike mbi shumën 2.000 € deri 5.800 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë, mbi shumën 1.500 € deri 4.860 €, për përjetimin e frikës, mbi shumën 1.000 € deri 4.200 € dhe për ushqim të përforcuar, mbi shumën 200 € deri 540 €, si dhe kërkesa e padisë me të cilin paditësi ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të rehabilitimit klimatik, paditësit t'ia paguaj shumën prej 1.600 €. Në pikën III., të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit, shumën e gjykuara në pikën I., të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar si dhe shpenzimet e procedurës, në shumën prej 1.024 € t'ia paguaj në afat

prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, në dorëzim e nën kërcënim të përmbarimit forcërisht.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë si e pa bazuar.

Pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën si të pa bazuar.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, pretendimet nga përgjigja në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padi ka kërkuar që ti bëhet kompensimi i dëmit lidhur me dëmin e pësuar duke punuar tek e paditura në vendin e punës axhustator – mirëmbajtës i shiritave të qymyrit, ashtu që me dt.07.09.2007 rreth orës 15,00 deri sa ka qenë duke i kryer detyrat e punës në shiritin e bartjes së qymyrit nr.14, ka rënë karroca shtrënguese e shiritit, ku edhe paditësit i ka zënë gishtat e dorës së majtë duke ia thyer gishtin e pestë dhe duke ia lënduar gishtin e katërt. Pala paditëse më tutje ka theksuar se, për shkak të lëndimit paditësi fillimisht është dërguar në Ambulancën e punëtorëve në Obiliq e më pastaj i njëjti është shtrirë në QKUK në Prishtinë ku është kryer edhe intervenimi kirurgjik. Gjykata e shkallës së parë pas zhvillimit të procedurës gjyqësore ka gjetur se: paditësi ka përjetuar dhembje fizike, ka pësuar frikë, i është bërë zvogëlimi i aktivitetit jetësor si dhe ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka gjetur se e paditura është përgjegjëse lidhur me shkakimin e dëmit paditësit nga se deri tek pësimi i lëndimeve të të njëjtit ka ardhur me fajin e të paditurës për shkak të mos ndërmarrjes të masave të duhura për mbrojtjen e punëtorit në punë. Gjykata e shkallës së parë pas nxjerrjes së provave të nevojshme, përkatësisht ekspertizës mjekësore dhe ekspertizës së ekspertit për mbrojtjen në punë ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit ndërkaq ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “ Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke

u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: ... d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 195.1 i LPK “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: ... e) ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë”.

Neni 154 i LMD: “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”.

Neni 200 par.1 i LMD: ” Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, te prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”.

Neni 200 par.2 i LMD: “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë pa themelta. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marr aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit e Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime dhe arsye adekuate për një vendosje të tillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatim i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës e dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në mënyrë të pjesshme.

Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e palës së paditur me ankesë, se e paditura nuk është përgjegjëse për dëmin e përshkruar nga ana e paditësit dhe se i kanë ndërmarr të gjitha masat lidhur me sigurim në punë, pasi që këtë në mënyrë të qartë dhe të gjithanshme, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar me marrjen e provës me nxjerrjen e ekspertizës nga fusha e mbrojtjes në punë, ku eksperti ka konstatuar se përgjegjësia për lëndimin e paditësit bie mbi të paditurën, nga se deri të lëndimi i paditësit ka ardhur me fajin e të paditurës për shkak të mosndërmarrjes së masave të duhura për mbrojtjen e punëtorit në punë, dhe jo si pasoj mos përdorimit e mjeteve mbrojtëse personale nga ana e paditësit.

Kolegji vlerëson gjithashtu se pretendimet ankimore të paditurës se shumatat e gjykuara janë të larta dhe nuk përkojnë me dëmin e pësuar nuk qëndrojnë, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet të qarta dhe të plota lidhur me aprovimin e kërkesëpadiës e paditësit si dhe për pjesën refuzuese të kërkesëpadiës. Shumat e gjykuara lidhur me dhembjet fizike, për frikën dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor për paditësin paraqesin satisfaksion të plotë në kuptim të nenit 200 par.1 të LMD dhe me standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e gjerë tanishme të gjykatave të Kosovës. Shumat të përcaktuara janë në përputhje me kriteret të parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye edhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Ndërkaq sa i përket kamatës, gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar e ka ndryshuar në pjesën e dispozitivit që ka të bëjë me kamatën e gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që në rastin konkret kamata caktohet me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar duke filluar me 10.07.2012 e deri të pagesa e plotë, në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3150/13, me dt.23.05.2016

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Mr.sc. Rafet Haxhaj